

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

31.03.2021

Ora 17:15

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, E.Meta.**

• **Parti Politike:** **PSD, LSI, PDIU, PS.**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëherë në seancën e sotme kemi për shqyrtim projektvendimin “Për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”. Pra, është pikë e rendit të ditës, e lënë pa shqyrtuar nga seanca e shkuar. Pastaj kemi në rend dite projektvendimin që ka të bëjë me “Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare të Shqipërisë”. Projektvendimi “Për lirim dhe emërim të disa anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve”. Projektvendimi “Për ndryshim në vendimin nr.148, datë 16.03.2021 të Komisionerit Shtetëror për caktimin e vendit të numërimit të votave për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25 Prill 2021”. Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Social Punetore Shqipëtare”. Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

ditës, që ka të bëjë me caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. I jap fjalën sekretarit për të relatuar projektaktin, pastaj përfaqësuesve të partive politike.

Z. Y. Merkaç: Atëherë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të nenit 96, të paragrafit 2 të Kodit Zgjedhor, ku organizon në seancë publike hedhjen e shortit ndërmjet partive politike, për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit. Për caktimin e partive politike që do të marrin pjesë në short dhe që në zbatim të rezultatit të tij do të fitojnë të drejtën për të propozuar anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit. Komisioneri bazohet në përcaktimin e Kodit Zgjedhor dhe konkretisht në nenin 95, paragrafi 2, i cili parashikon se anëtari i tretë propozohet nga partitë politike të shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e grupeve të numërimit. Neni 96, paragrafi i parë, parashikon se partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ, ndërmjet listës së partive politike me shumicë parlamentare dhe listës së partive politike të opozitës parlamentare, të regjistruar në zgjedhjet që kanë fituar jo më pak se 2 mandate, në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Me vendimin nr.525 datë 26.07.2017, KQZ ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017 për Kuvendin e Shqipërisë dhe numri i mandateve të fituara nga partitë politike është si më poshtë:

- 1.Partia Socialiste, 74 mandate;
- 2.Partia Demoratike, 43 mandate;

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

3.Lëvizja Socialiste për Integrim, 19 mandate;

4.Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, 3 mandate;

5. Partia Socialdemokrate, 1 mandat.

Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-ve, respektivisht Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, nuk renditen në listën e partive që të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt. Partitë politike që kanë fituar në Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2017 jo më pak se dy mandate, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe zëvendëskryetarin, janë Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet. Referuar nenit 2 paragrafit të 2-të dhe të 3-të të udhëzimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.5 datë 16.03.2021. Nga partitë politike me shumicë parlamentare, Partia Socialdemokrate nuk përmbush kriterin e numrit të mandateve për të qenë pjesë e shortit për caktimin e anëtarit të tretë të anëtarëve të grupit të numërimit. Partia Socialiste e Shqipërisë është e vetmja parti që plotëson kriterin e numrit të mandateve nga partitë e shumicës parlamentare, për të propozuar anëtarin e tretë të grupeve të numërimit. Nga partitë politike të opozitës parlamentare, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, përmbushin kriterin e numrit të mandateve dhe ju lind e drejta të bëhen pjesë e shortit për të përcaktuar anëtarin e katërt të grupeve të numërimit. Për sa më lart KQZ brenda kompetencave të tij, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”, faleminderit!

Z. I .Celibashi: Mirë, faleminderit! Përfaqësues të partive politike? Përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit i nderuar zoti Komisioner! Pasi jemi njohur me përmbajtjen e aktit, vlerësuar se përmbajtja e tij bie ndesh me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe sa me lart referoj që: Më konkretisht neni 183, pika 8 e Kodit Zgjedhor rezulton se, në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet paravendore pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarit të KZAZ-së, KQV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimi shumicë-pakicë në Kuvendin, në çeljen e tij menjëherë pas këtyre zgjedhjeve. Gjithashtu referuar nenit 65 të Kodit Zgjedhor parashikohet se: Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të Kodit mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Partitë politike pjesëmarrëse në koalicion nuk mund të marrin pjesë në koalicion tjetër dhe as të paraqesë kandidat apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë. Pika e tretë, në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklaroj partinë politike udhëheqëse të koalicionit, për nevojat dhe zbatimet e këtij ligji. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëmarrëse në koalicion dhe detyrimeve reciproke midis tyre rregullohen me marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet në koleksionin e KQZ-së. Nga informacionet zyrtare rezulton se subjekti politik PDIU është regjistruar pranë KQZ-së si pjesë e një koalicioni zgjedhor me parti udhëheqëse Partinë Demokratike të Shqipërisë. Në vijim të këtij arsyetimi PDIU kërkon të drejtën e numëruesit të dytë, sipas parashikimeve të nenit 96 të Kodit Zgjedhor, referuar kjo dhe bazuar në nenin 96 pika 2. Subjekti politik PD e gëzon numëruesin. Automatikisht dhe rrjedhimisht rezulton se PDIU e përmbush dhe elementi i interesit të ligjshëm lidhur me numëruesin e votave. Kjo

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

praktikë për më shumë është mbajtur dhe nga Kolegji Zgjedhor në 2019-tën i nderuar zoti Kryetar. Lidhur me ankimin e bërë nga PD dhe LSI, i cili ka përcaktuar të drejtat dhe detyrimet për nivelet e dyta dhe të treta të administrimit zgjedhor, lidhur ngushtësisht me interesin e ligjshëm të partisë politike që bën kërkesë. Për sa u relatua më sipër vlerësojmë se numëruesi i katërt i takon Lëvizjes Socialiste për Integrim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Fjalën ia jap përfaqësuesit të partisë PDIU.

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Po, faleminderit zoti Komisioner! Më vjen shumë keq që kolegu që është afër, por njëkohësisht dhe partner në koalicionin opozitar nuk po e shikon në mënyrë të qartë për sa i përket trajtimit që i ka bërë këtij projektvendimi administarta e KQZ-së. E thënë dhe nga Komisioneri që për hir të së vërtetës i kanë sjellë në përputhje me ligjin dhe konform me Kodin Zgjedhor udhëzimet dhe aktet e tjera të dala në zbatim të saj. Më duhet të citoj nenin 19 “Kompetencat e Komisionerit”. Midis të tjerash në pikën “II” thekson se kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe në formë nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra detyrimi sipas ligjit në këtë këndvështrim. Dhe korrekt në këtë pikë, Komisioneri ka paraqitur projektvendime për caktime politike që do të propozojnë anëtarët e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Siç u relatua, ky projektvendim vjen në mbështetje të nenit 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor, konkretisht të nenit 96 paragrafi i parë, ku më duhet ta citoj dhe njëherë “Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë Kryetarin dhe Nënkyetarin e KZAZ-së, përcaktojnë pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

shumicës parlamentare dhe listës së partive politike të opozitës parlamentare, të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se 2 mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë”. Me të drejtë, administrata dhe Komisioneri duke iu referuar vendimit nr.555 të datës 26.07.2017 për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të vitit 2017, ka përcaktuar dhe mandatet e partive, të cilat janë: LSI, 19 mandate; PDIU, 3 mandate; PS, 1 mandat. Ndërsa, 2 partitë e tjera kryesore kanë mandate 74 dhe 43. Referuar nenin 2 paragrafit 2 dhe 3 të Udhëzimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.5 të datës 16.03 për procedurat e hedhjes së shortit, për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt. Në mënyrë ligjore është përcaktuar se nga partitë politike të opozitës parlamentare, partia LSI dhe PDIU përmbushin kriterin e numrit të mandateve dhe u lind e drejta të bëhen pjesë e shortit për të caktuar anëtarin e katërt. Këtu zoti Komisioner u komentua çështja e koalicioneve. Nëse ju kujtohet, se unë pata fatin që isha në Komisionin e Reformës Zgjedhore, i cili e ka miratuar...e ka çuar në parlament dhe është miratuar me shumicë votash, përjashto vetëm 2,3 pika ku ka përcaktuar edhe disa dispozita kalimtare në lidhje për sa i përket formimit kalimtar i organeve drejtuese dhe administratës zgjedhore nr.183 i këtij Kodi. Konkretisht në pikën 8, në zgjedhjet e para të përgjithshme, në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-së, KQV-së dhe GNV-së, përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit nga çelja e tij menjëherë mbas këtyre zgjedhjeve. Siç cituam më sipër dhe në projektvendimin nga ana e administratës dhe Komisionerit, është përcaktuar shumë saktë se kush janë partitë e opozitës parlamentare. Në lidhje me koalicionet, ne kemi bërë një koalicion para zgjedhor me Partinë Demokratike si dhe forca LSI ka bërë një koalicion para zgjedhor dhe në këto koalicione duke ju referuar nenit

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

65, në pikën 3 citohet midis të tjerave: “Marrëdhëniet midis partive pjestare të koalicioneve dhe detyrat përkatëse reciproke midis tyre rregullohen nga marrëveshjet e koalicionit, të cilat janë pjesë e dokumentacionit që depozitohen në KQZ. Kjo marrëveshje është tashmë në KQZ dhe në asnjë moment, në asnjë rast nuk është përcaktuar se do të kishte detyrime apo pengime të këtyre forcave politike për mosgëzimin e të drejtës që i jep ligji, siç është rasti i propozimit të anëtarëve të grupeve të numërimit. Nëse do të niseshim me një rast hipotetik i nderuar Komisioner. Nëse do të kishim një parti parlamentare tjetër opozitare, përveç LSI-së dhe PDIU-së dhe kjo parti do të kishte dalë më vete në këto zgjedhje. Do të garonte. A do të hidhej në short, apo jo?! Më duhet të sjell në vëmendje të këtij komisioni, i nderuar Komisioner dhe një vendim që tashmë i përket datës 12.06.2017 për zgjedhje te vitit 2013, ku është me disa anëtarë, ku në këtë rast forca për Drejtësi Integrim dhe Unitet ishte në koalicion me LSI-në dhe në krahun tjetër kishim Partinë Republikane dhe KQZ-ja në atë kohë, në mënyrë ligjore i ka përcaktuar këto parti. Ju ka dhënë mundësinë që të caktojnë një nga anëtarët e grupeve të numërimit. Pra i ka bërë pjesë të shortit dhe nuk e kuptoj se pse ky propozim apo ky mendim që ka forca e LSI-së, që është në kundërshtim të ligjit. Atëherë, nëse do të ishte në kundërshtim të ligjit, përse do ta sillte KQZ-ja apo Komisioneri? Ku në mënyrë korrekte, gjatë gjithë kësaj periudhe ka qenë shumë korrekt në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe të akteve të tjera. Prandaj ne zoti Komisioner kërkojmë miratimin nga ana juaj të këtij projektvendimi, pasi është konform ligjit dhe në zbatim të Kodit Zgjedhor, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, me sa kuptova nga diskutimi i të dy përfaqësuesve të partive politike të ndryshme, jemi përpara dy pretendimeve në kundërshtim me njëra-tjetrën. Pra, LSI pretendon që PDIU e ka humbur të drejtën

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

për të patur anëtar të grupit të numërimit, për faktin sepse tashmë është pjesë e një koalicioni dhe të gjitha të drejtat, detyrimet e kësaj partie politike i ka përfshirë koalicioni ose partia udhëheqëse e koalicionit. Kurse nga ana tjetër përfaqësuesi i PDIU-së pretendon që pavarësisht faktit që kjo parti nuk është pjesëmarrëse në zgjedhje si subjekt zgjedhor, përsëri e ruan të drejtën e vet për të patur anëtar të grupit të numërimit, qoftë edhe për faktin që është e regjistruar si parti pjesëmarrëse në zgjedhje, por nuk paraqet kandidatët e vet drejtpërsëdrejti, por kandidatët e saj atje ku janë në listën shumëmemërore të koalicionit. Pak a shumë në mënyrë të përmbledhur këto janë të dy pretendimet e secilës prej palëve. Unë një pyetje kam për përfaqësuesin e PDIU-së. Juve e konsideroni veten subjekt zgjedhor? Pra, PDIU është subjekt zgjedhor? Është pjesëmarrëse në këto zgjedhje? Kandidon me kandidatët e vet në këto zgjedhje?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Marrëveshjen zoti Komisioner... Marrëveshja ka konsistuar në qëllimin dhe në arritjen e një rezultati pozitiv për të krijuar shumicën. Ky është në thelb koalicioni duke ju referuar dhe nenit 65. Nuk kam dëgjuar ndonjëherë në kaq kohë përvojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve apo me zgjedhjet, që një koalicioni t'i mohohet e drejta e gëzimit të një dispozite ligjore, një subjekti zgjedhor apo jo. Ne garojmë në këtë koalicion për programin apo dhe për pikat e tjera, për të arritur qëllimin e caktuar midis këtyre dy forcave, por në asnjë mënyrë ne në fletën e votimit, identifikohemi me siglën e Partisë për Drejtësi Integrim dhe Unitet. Normalisht mendoj që, ky diskutim i nderuar Komisioner nuk është i pranueshëm në këtë pikë. Pra, unë solla për analogji një vendim të vitit 2017, njëkohësisht bëra dhe një hipotetizim. Nëse do të ishte një parti tjetër, jo LSI e PDIU, por do të ishte një parti tjetër në opozitë, që kishte marrë më shumë se dy mandate, a do të futej në short apo jo?! Prandaj, unë mendoj

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021**

që akti i sjellë, projektvendimi i sjellë nga ana e administratës është shumë korrekt dhe ligjor dhe nuk jemi para faktit që... sipas llogjikës së përfaqësuesit apo edhe pyetjes suaj i nderuar Komisioner, është që ne duhet të hidhnim në short për një nga anëtarët e numërimit midis PD dhe PDIU-së. Që nuk shkon, sepse neni 60, më fal, neni 95 e ka përcaktuar fare qartë se kujt i takon dhe neni 96 po përsëri e ka përcaktuar. Përmenda edhe dispozitat kalimtare zoti Komisioner, e cila e sqaron fare qartë. Nëse do t'i nisemi parimit të përgjithshëm kushtetues që shpeshherë unë në përvojën time si avokat po dhe juve që keni qenë në pozicione të tilla më të larta se avokati, asnjë dispozitë e këtij ligji nuk mund të zbatohet ose interpretohet në kundërshtim, ose në shkelje të parimeve kushtetuese. Prandaj zoti Komisioner, nuk ka vend për të diskutuar që i takon, apo nuk i takon, apo është pjesë, subjekt zgjedhor për të pasur të drejtën e caktimit të një anëtari dhe për të qenë pjesë e shortit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! E fundit, përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit i nderuar zoti Celibashi! E bëj me dije kolegun se meqë s'kishte dëgjuar ndonjëherë, domethënë një praktikë të tillë. Normalisht nuk ka se si t'a degjonte, për shkak se ndryshimet e bëra me ligjin 118/2020, kanë futur pikën e tretë të nenit 65. Të cilat, kompetencat, detyrimet dhe të drejtat ia kalon përfaqësuesve të partive në një koalicion. Kështu që, është hera e parë me ndryshimet e Kodit Zgjedhor që parashikohet një gjë e tillë. Dhe pikë së dyti, këtu në fletën e votimit ne nuk do të shohim siglën e PDIU-së. Çfarë do të numërojë numëruesi i PDIU-së, siglat e tjera? Çfarë do të garantojë

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

numëruesi i PDIU-së, votat e LSI-së? Votat e PSD-së? Votat e PS-së? Ja, është llogjikë e thjeshtë.

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Mundet! Zoti Komisioner, përpos të tjerave unë solla në vëmendje dhe një akt të miratuar nga ky institucion, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pikërisht vendimin e datës 12.06.2017. Deri në këtë kohë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ecur dhe në praktikën e vendimeve të mëparshme përsa i përket administrimit zgjedhor. Dhe në këtë rast, mendoj se duhet të ketë parasysh këtë fakt. Prandaj ardhja e projektvendimit nga administrata dhe nga Komisioneri, është mëse e qartë dhe mëse ligjor, prandaj kërkojmë miratimin e tij. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Unë në cilësinë e Komisionerit, pasi dëgjova dhe pretendimet e dy përfaqësuesve të partive politike, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partisë për Drejtësi Integrim dhe Unitet, vlerësoj se ajo çfarë pretendon përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim qëndron, është e bazuar në ligj, pra në Kodin Zgjedhor. Është e vërtetë që Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet është një parti politike e cila sëbashku me Lëvizjen Socialiste për Integrim kanë marrë më shumë se 2 mandate në zgjedhjet e 25 Qershorit të vitit 2017. Respektivisht Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet ka marrë 3 mandate dhe Lëvizja Socialiste për Integrim ka marrë 19 mandate. Por, fakti i të pasurit më shumë se dy mandate, jo automatikisht të jep të drejtën, për të pasur të drejtën, për të propozuar, ose për të qenë pjesë e shortit për anëtarin e tretë dhe të katërt të grupit të numërimit, sepse nëse Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet nuk do të ishte pjesëmarrëse në zgjedhje, si e paregjistruar fare, po marr rastin më klasik, atëhere natyrshëm mungonte interesi i ligjshëm i këtij subjekti politik, për të pasur

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

anëtar në grupin e numërimit. Është e vërtet që Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet është e regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhje, por nuk është subjekt zgjedhor, sepse nuk konkuron me listën shumëmemërore të sajën. Disa kandidat për deputet të paraqitur nga koalicioni ku kjo parti bën pjesë, konsiderohen si kandidat të paraqitur nga kjo parti. Po për ligjin, për Kodin Zgjedhor, kandidatët për deputet të paraqitur në këtë rast janë kandidat për deputet të paraqitur nga koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” dhe ky është subjekti zgjedhor që merr pjesë në zgjedhje. Ashtu sikurse në fund edhe përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim tha, qoftë edhe për faktin e vetëm që mungon interesi i ligjshëm, pasi kështu është ndërtuar Kodi Zgjedhor, në një lloj balance ndërmjet opozitës dhe pozitës, në lidhje me administrimin e procesit zgjedhor. Në këtë rast mungon ajo lidhja e drejtëpërsëdrejtë e interes të ligjshëm ndërmjet partisë politike Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet dhe administrimit të procesit zgjedhor. Ndaj, për këto arsye, si dhe bazuar në nenin 19 paragrafi “1” shkronja “n” dhe 2 neni 95 paragrafi “2” dhe neni 96 paragrafi “1” të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë vendos:

1. Partia politike e shumicës parlamentare që ka të drejtë të propozoj anëtarin e tretë të grupit të numërimit të votave për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, është Partia Socialiste.
2. Pika e dytë, partia politike e opozitës parlamentare që ka të drejtë të propozojë anëtarin e katërt të grupit të numërimit të votave për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, është Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, faleminderi!

Vendimi nr. 193

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

31.03.2021
Ora 17:41

RENDI I DITËS

Projektakti “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e partisë Aleanca Arbnore Kombëare të Shqipërisë, zj. Marte Nikoll Suta”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E. Meta**
- **Parti Politike: PS, LSI , PSD**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit ditës!

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Lezhë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës nga këshilltari zj. Monika Paçuku, propozuar nga subjekti politik Partia Aleanca Arbnore Kombëtare. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare është kandidati me numër rendor 4, Marte Suta. Kandidati për këshilltar ka depozituar dhe plotësuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit dhe nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me ndalimet, me parashikimet për ndalime në ligjin numër 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore për kandidatin për anëtarë të këshillit të Bashkisë Lezhë që ka dorëzuar formularin

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021**

e vetdeklarimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se nuk ka shënime, nuk ka të regjistruar në sistem dënime penale të formës së prerë. Referuar pikës 2 të Kreut 5 të vendimit numër 17 të vitit 2016 të Kuvendit konstatojë se të dhënat e kandidati për anëtarë, zonjës Marte Suta, në Këshillin e Bashkisë Lezhë nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtimin dhe miratimin. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Diskutime nga përfaqësues të partitë politike? Nuk ka. Mirë atëherë, bazuar në sa u relatua si dhe në dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor vendos:

1. Zonja Marte Nikoll Suta, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Arbnore Kombetare, zj. Marte Nikoll Suta.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr.194

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

**31.03.2021
Ora 17:42**

RENDI I DITËS

Projektakti “Për lirim dhe emërim të disa anëtarëve dhe të një sekretari të KZAZ-ve”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E. Meta**
- **Parti Politike: PS, LSI , PSD**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit ditës!

Z.Y.Merkaj: Bazuar në nenin 32, paragrafi 2, shkronja “d” të Kodit Zgjedhor, Partia Social Demokrate, në datën 25 dhe 26 i tetorit 2021 ka kërkuar: lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ-së numër 29-të, 33, 36 dhe 40 të Qarkut Tiranë, lirim dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së numër 70-të, 74 dhe 75 të Qarkut Korçë. Partia Socialiste në datën 24 dhe 26.03. 2021 ka kërkuar: lirim dhe emërimin e dy anëtarëve KZAZ-së nr. 9, Qarku Kukës lirim dhe emërimin e dy anëtarëve të KZAZ-së nr. 11, Qarku Kukës. Lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr.15, Qarku Lezhë. Lirim dhe zëvendësimin e anëtarit të dy anëtarët e KZAZ-së nr.36 Qarku Tiranë. Lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr.39 Qarku Tiranë. Partia Socialiste për Integrim në datë 24 dhe 26.03.2021 ka kërkuar: lirim dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 44, Qarku Elbasan. Lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr.57, 58 dhe 60 të

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

Qarkut Fier. Partia Demokratike në datë 25.03.2021, ka kërkuar: lirim e zëvendësimin anëtarit të KZAZ-së nr.11, Qarku Kukës. Propozimet e partive të Partisë Social Demokrate, Partisë Socialiste, Partisë Socialiste për Integrim dhe Partisë Demokratike për zëvendësimin e anëtarëve janë në përputhje me nenin 29, 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën për lirim dhe zëvendësim të anëtarëve, faleminderi!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit!

1.Atëherë, miratohet lirimi nga detyra i anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur, nuk po i lexoj emrat dhe emërohen në detyrë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e KQZ-së dhe i njoftohet KZAZ-ve përkatëse.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.195

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

31.03.2021
Ora 17:45

RENDI I DITËS

Projektakti “Për një ndryshim në vendimin nr.148 të datës 16.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E. Meta**
- **Parti Politike: PS, LSI , PSD**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit ditës.

Z.Y.Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin numër 148, datë 16 Mars 2021 ka caktuar vendin e numërimit të votave për 92 KZAZ-të, ndër të tjera dhe vendodhjen e vendit të numërimit të votave të KZAZ-së numër 84, Qarku Vlorë. Ku është miratuar “Pallati i Kulturës” si vend i numërimit të votave. Prefekti i Qarkut Vlorë në datën 31.03.2021 ka propozuar si ambient të përshtatshëm për vendin e numërimit të votave të ZAZ-së nr.84, nga “Pallati i Kulturës Labëria”, në “Pallatin e Sportit Flamurtari” duke argumentuar se ndodhet në distancë më të afërt me Qendrat e Votimit, ka hapësirë më të përshtatshme për të përmbushur masat antikovid, ka ndricim dhe kushte më të favorshme për VNV-në. Ky ambient është verifikuar dhe inspektuar dhe nga KZAZ-ja dhe nga Bashkia e Vlorës dhe ka rënë dakord që të bëhet ndryshimi nga “Pallati i Kulturës Labëria” në “Pallatin e Sportit Flamurtari” duke marrë përsipër dhe të ndahet “Pallati i

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

Sportit” pasi atje është edhe ZAZ-ja numër 86-të. Duke qënë se plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 93-94 i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që të ndryshohet vendi i numërimit të votave nga “Pallati i Kulturës Labëria” në “Pallatin e Sportit Flamurtari”, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësues të partive politike diskutim? Nuk ka.

1. Atëhere miratohet ndryshimi i vendodhjes së vendit të numërimit të votave për KZAZ-në numër 84 nga “Pallati i Kulturës Labëria” transferohet tek “Pallati i Sportit Flamurtari”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në KAS.

Vendimi nr.196

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

**31.03.2021
Ora 17:46**

RENDI I DITËS

Projektakti “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Social Punëtore Shqiptare, z. Aleksandër Kolvataj”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, E. Meta**
- **Parti Politike: PD, LSI , PSD**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit ditës.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Lezhë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari Elton Ivanaj propozuar nga subjekti politik Partia Social Punëtore Shqiptare. Referuar nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Social Punëtore Shqiptare është këshilltari me numër rendor 3, zoti Aleksandër Kolvataj, i cili ka plotësuar edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e deklarimit, nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin numër 138 të vitit 2015-të. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore dhe Zyra e Gjendjes Civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje kërkesës sonë. Drejtoria e Përgjithshme Gjendjes

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.31.03.2021*

Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit për anëtarë të Këshillit të Bashkisë Lezhë ku rezulton se nuk ka shënime në sistem për dënime penale. Referuar pikës 2 të Kreut 5 (pesë) të vendimit nr. 17 të vitit 2016-të Kuvendit, konstatojmë se të dhënat e kandidatit për anëtarë të Këshillit të Bashkisë Lezhë zotit Aleksandër Kolvataj nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive politike? Nuk kanë diskutime. Mirë atëherë. Bazuar në sa u relatua dhe në dispozitat e Kodit Zgjedhor përkatëse vendos:

- 1.Zoti Aleksandër Pashko Kolvataj, kandidat për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Lezhë nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
- 2.Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidatin nga lista shumëmemërore nga lista e Partisë Social Punëtore Shqiptare zotin Aleksandër Pashko Kolvataj.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Faleminderit! Mirë atëhere, këto ishin çështjet për shqyrtim në rendin e ditës në këtë seancën e sotme, çështje të tjera nuk kemi, seanca mbyllet, faleminderit për kontributet!

Vendimi nr.197

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*

